**VENDIM**
**Nr. 327, datë 31.5.2018**

# PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 395, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

"12/1. Për mbështetjen e procesit të integrimit evropian, institucionet sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, angazhojnë numrin e përcaktuar të praktikantëve që do të punojnë në funksion të procesit të integrimit evropian, nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përgatitjen e *database*-ve me të dhënat e çdo institucioni.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

Lidhja nr. 1

| Institucioni | Propozimi për numër kontratash internship të studentëve për punë operatore |
|---|---|
| Kryeministria | 3 |
| Ministria e Brendshme (MB) | 3 |
| Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) | 4 |
| Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) | 2 |
| Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) | 4 |
| Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) | 5 |
| Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) | 3 |
| Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) | 5 |
| Ministria e Kulturës (MK) | 2 |
| Ministria e Mbrojtjes (MM) | 2 |
| Ministria e Drejtësisë (MD) | 3 |
| Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) | 2 |